

DEMOKRACIA PJESËMARRËSE

Demokracia nuk është asnjëherë e mjaftueshme, sidomos për vende që e kanë njohur pak dhe pjesërisht atë. Ne besojmë te **demokratizimi i vazhdueshëm i shtetit dhe shoqërisë**. Ne synojmë një demokraci sa më pjesëmarrëse, ku qytetarëve u garantohet e drejta e iniciativës ligjvënëse dhe e votimit të ligjeve. Ndaj do të përpiqemi t'u sigurojmë **qytetarëve të drejtën e iniciativës ligjvënëse me referendum** dhe të lehtësojmë organizimin e referendumeve. Kjo do të kërkonte uljen e pragut të nënshkrimeve qytetare për një referendum, sigurimin e afateve të mjaftueshme kohore për mbledhjen e nënshkrimeve dhe mbështetjen financiare shtetërore të procesit të mbledhjes së nënshkrimeve nga grupet nismëtare.

Në demokracitë moderne elementi i përfaqësimit është i pashmangshëm. Por Lëvizja Bashkë do të synojë **demokratizimin themelor të sistemit zgjedhor**. Kjo do të kërkonte vendosjen e një **sistemi zgjedhor proporcional kombëtar**. Po ashtu lehtësimin e kushteve dhe procedurave për kandidatët e pavarur që vijnë si rezultat i iniciativave qytetare, duke mundësuar kështu një përfaqësim sa më të drejtë të pluralitetit shoqëror. Në zgjedhjet qendrore e vendore ligji duhet t'u njohë iniciativave qytetare të drejtën për të kandiduar me lista deputetësh dhe këshilltarësh bashkiakë.

Lëvizja Bashkë zotohet të luftojë për **të drejtën e shtetasve shqiptarë me banim jashtë Shqipërisë për të votuar** prej vendeve ku jetojnë. Nuk mund të ketë demokraci të njëmendtë pa lirinë dhe pluralitetin e mediave, si dhe pa mbrojtjen e punës së gazetarëve. Kjo kërkon **themelimin dhe promovimin e sa më shumë mediave që nuk kontrollohen nga oligarkët** dhe as janë nën ndikimin e pushtetit politik. Në të gjitha mediat, faktor themelor i hulumtimit të paanshëm dhe lirisë së kritikës është **organizimi i gazetarëve në sindikata të pavarura** e të fuqishme, duke e kthyer redaksinë në drejtuesen e vërtetë të punës hulumtuese e raportuese.

Demokracia politike është e mangët dhe e brishtë nëse nuk shoqërohet me masa që do të nxisnin demokratizimin e marrëdhënieve ekonomike e shoqërore. Lëvizja Bashkë mendon se **punëtorët duhet të kenë zë të rëndësishëm në administrimin e vendit të punës**, si dhe në vendimmarrjen brenda tij. Kësisoj, për ndërmarrjet e mëdha dhe sipërmarrjet që përfitojnë kontrata nga shteti, ne synojmë që ligji t'u garantojë **organizatave punëtore vende të mjaftueshme në bordet e administrimit**. Kjo masë jo vetëm do të rriste sigurinë në punë dhe mbronte dinjitetin e punëtorëve, por edhe do të ishte një shtysë e nevojshme për identifikimin e punëtorëve me fatet e ndërmarrjes dhe rritjen e cilësisë së punës.

Organizimi shoqëror dhe vetadministrimi i të përbashkëtave është komponenti i tretë i demokratizimit të njëmendtë të vendit. Lëvizja Bashkë synon të nxisë format më të larmishme e të gjera të **organizimit shoqëror: nga vendbanimi në shkolla, nga profesioni në sporte, art e veprimtari të pasioneve kolektive**. Duam të theksojmë veçanërisht **organizimin e jetës urbane prej komuniteteve të pallateve e të lagjeve**, të cilat duhet të kenë kompetenca vendimmarrëse dhe të trajtohen si partnere të rëndësishme nga organet e pushtetit vendor. Po ashtu krejt **hapësirat e përbashkëta** duhen administruar sipas metodave kolegjiale ku përfshihen përfaqësues të institucioneve publike dhe përfaqësues të shoqatave, grupimeve e forumeve profesionale e qytetare. Një qytet i jetueshëm është përftesë e angazhimit dhe koordinimit të gjithë shumësisë qytetare.

Ne, aktivistët e Lëvizjes Bashkë, të vetëdijshëm për problemet dhe sfidat e shoqërisë sonë, krenarë për arritjet historike të popullit shqiptar, të frymëzuar nga lëvizjet emancipuese shoqërore kombëtare e botërore, me besim te liria, barazia, solidariteti e dinjiteti njerëzor, të vetëdijshëm për rëndësinë e zhvillimit ekonomik e drejtësisë shoqërore, vlerësues të rolit të punës dhe krijimtarisë individuale e kolektive, të përkushtuar ndaj demokracisë dhe pjesëmarrjes qytetare, dëshmojmë ekzistencën tonë politike dhe ftojmë çdo qytetar t'i bashkohet përpjekjes për të mirën e përbashkët!